


Kapitulli 1

Kuadri Konceptual

Objektivat e kapitullit

Në përfundim të këtij kapitulli, ju do të keni mundësi të:

- Vlerësoni modelet e vlerësimit të adoptuara nga hartuesit e standardeve;
- Diskutoni për përdorimin e një kuadri konceptual si bazë për përmirësimin e standardeve të kontabilitetit;
- Vlerësoni suksesin e një kuadri të tillë gjatë prezantimit të standardeve të kontabilitetit rigoroze dhe konsistente;
- Identifikoni marrëdhënien midis teorisë së kontabilitetit dhe praktikës;
- Vlerësoni në mënyrë kritike parimet dhe praktikatat e kontabilitetit të përdorura në raportimin e korporatave.



1. Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar

Hyrje: Nevoja për një kuadër konceptual

Kuadri konceptual është një grup parimesh dhe konceptesh teorike që udhëzojnë në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.

Nëse nuk do të ekzistonte një kuadër konceptual, atëherë me shumë gjasa standardet e kontabilitetit do të hartoheshin në mënyrë të rastësishme, bazuar në çështjet dhe rrethanat e veçanta që lindin. Këto standarde të kontabilitetit mund të ishin të paharmonizuar me njëri-tjetrin, ose ndoshta mund të binin në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Pra, një kuadër konceptual i fortë do të thotë se ekzistojnë një sërë parimesh mbi të cilat bazohen të gjitha standardet e ardhshme të kontabilitetit. Ai gjithashtu vepron si pikë referimi për hartuesit e pasqyrave financiare nëse nuk ka një standard të kontabilitetit të përshtatshëm që rregullon llojet e transaksioneve që një entitet realizon (kjo do të jetë jashtëzakonisht e rrallë).

Ky seksion i tekstit e trajton përmbajtjen e Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar ("Kuadri") në më shumë detaje.

Qëllimi i Kuadrit

Qëllimi i Kuadrit është:

- a) Të ndihmojë Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (Bordin) gjatë zhvillimit të standardeve të reja;
- b) Të ndihmojë hartuesit e standardeve kombëtare që të zhvillojnë standarde të reja;
- c) Të japë udhëzime për çështjet që nuk mbulohen nga Standardet e SNRF-ve;
- d) Të ndihmojë audituesit.

Objektivat e raportimit financiar

Kuadri thotë se objektivi i raportimit financiar është të ofrojë informacion për investitorët ekzistues dhe potencialë, huadhënësit dhe kreditorët e tjerë, që i ndihmon ata gjatë marrjes së vendimeve për sigurimin e burimeve të entitetit raportues.

Supozimi bazë

Kuadri identifikon bazën e vijimësisë si supozim bazë që udhëheq përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza e vijimësisë supozon se njësia ekonomike nuk do të likujdojë ose pakësojë nivelin e operacioneve të saj.

Karakteristikat cilësore të informacionit të dobishëm financiar

Kuadri identifikon llojet e informacionit që është i dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare.

Ai identifikon dy karakteristika cilësore themelore të informacionit të dobishëm financiar:

(1) Përkatësia

Informacioni është i rëndësishëm nëse do të ndikojë në vendimet e marra nga përdoruesit e tij.

- Informacioni i rëndësishëm ka vlerë parashikuese ose konfirmuese për një përdorues;

- Përkatësia mbështetet nga vlerësimet për materialitetin:

- Informacioni konsiderohet material nëse mungesa apo anomali e tij mund të ndikojnë në vendimet e marra nga përdoruesit e këtij informacioni;

- Mungesa apo anomalia mund të jetë materiale për shkak të madhësisë ose natyrës së saj;

- Materialiteti është një vlerësim që bëhet në mënyrë specifike për një entitet, dhe në këtë mënyrë kuadri nuk përcakton një kufi minimal.

(2) Paraqitja me besueshmëri

Informacion financiar i paraqitur me besueshmëri, duhet të jetë:

- I plotë
- Neutral
- Pa gabime.

Prandaj, ai duhet të përfshijë informacionin e nevojshëm për një kuptim të duhur, ai duhet të jetë pa paragjykim ose manipulime dhe i përshkruar qartë.

Përveç dy karakteristikave cilësore themelore, ekzistojnë edhe katër karakteristika që përmirësojnë cilësinë e informacionit të dobishëm financiar. Këto karakteristika duhet të maksimizohen kur është e mundur:

(1) Krahasueshmëria

Informacioni është më i dobishëm nëse mund të krahasohet me informacione të ngjashme rreth njëjësive ekonomike të tjera, apo edhe të vetë njësisë ekonomike gjatë periudhave të ndryshme kohore.

Qëndrueshmëria në paraqitje ndihmon në arritjen e krahasueshmërisë së informacionit financiar. Lejimi i trajtimeve të ndryshme kontabël për zëra të ngjashëm ka të ngjarë të zvogëlojë krahasueshmërinë.

(2) Verifikueshmëria

Kuadri shpjegon se verifikueshmëria do të thotë që "**vrojtues/vëzhgues të ndryshëm, të mirëinformuar dhe të pavarur mund të arrijnë konsensusin, edhe pse jo domosdoshmërisht marrëveshje të plotë, që një paraqitje e vecantë e një zëri apo disa zërash është një paraqitje besnike**" (Kuadri, paragrafi QC26)

Verifikueshmëria e informacionit financiar siguron përdoruesit në lidhje me kredibilitetin dhe besueshmërinë e tij.

(3) Paraqitja në kohë

Informacioni duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve brenda një afati kohor që ka të ngjarë të ndikojë në vendimet e tyre. Informacioni i vjetër është më pak i dobishëm.

(4) Kuptueshmëria

Informacioni duhet të paraqitet në mënyrë të qartë dhe konçize.

<u>Kujdesi</u>
Versionet e kaluara të Kuadrit i referohen rëndësisë së konceptit të kujdesit.
Të jesh i kujdesshëm do të thotë të ushtrosh kujdes. Në raportimin e korporatave, kjo shpesh interpretohet në kuptimin që entitet nuk duhet të zmadhojnë aktivet ose të zvogëlojnë detyrimet e tyre.
Bordi hoqi parimin e kujdesit nga Kuadri sepse ata mendonin se ishte i paharmonizuar me neutralitetin. Kjo është për shkak se zvogëlimi i aktiveve në një periudhë ka gjasa të çojë në tejkalimin e performancës financiare në periudhën e ardhshme.
Megjithatë, siç diskutohet më vonë në këtë kapitull, Bordi po konsideron rivendosjen në Kuadri Konceptual të një reference të qartë për kujdesin.

Kufizimi i kostos

Është e rëndësishme që kostot e shkaktuara në raportimin e informacionit financiar të justifikohen nga përfitimet që informacioni i sjell përdoruesve të tij.

Elementet e pasqyrave financiare

Efektet financiare të një transaksioni mund të grupohen në klasa të gjera, të njohura si elemente.

Sipas Kuadrit Konceptual, ekzistojnë pesë elemente të pasqyrave financiare:

Aktivët - burimet e kontrolluara nga një entitet si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, që do të çojë në flukse të mundshme të përfitimeve ekonomike.

Detyrimet - obligimet e një entiteti që lindin nga një ngjarje e kaluar, që do të çojë në një rrjedhje të mundshme të burimeve ekonomike.

Kapitali neto – vlera e aktiveve neto të një entiteti pas zbritjes së detyrimeve të saj.

Të ardhura - rritja e përfitimeve ekonomike gjatë periudhës raportuese.

Shpenzimet - zvogëlimi i përfitimeve ekonomike gjatë periudhës raportuese.

Njohja e elementeve të pasqyrave financiare

Kuadri shprehet se një zë duhet të njihet në pasqyrat financiare nëse:

- Përbush përkufizimin e një elementi;
- Është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen do të rrjedhin tek ose nga entiteti;
- Zëri mund të matet me besueshmëri.

Matja e elementeve të pasqyrave financiare

Matja është procesi i përcaktimit të vlerës me të cilën elementët duhet të njihen dhe të mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Kuadri identifikon katër baza të mundshme të matjes:

Kosto historike

Aktivitetet regjistrohen me vlerën e paguar për blerjen e tyre.

Detyrimet regjistrohen me vlerën e të ardhurave të marra ose me vlerën që pritet të paguhet për të përbushur detyrimin.

Kosto aktuale

Aktivitetet mbahen me çmimin e tyre aktual.

Detyrimet mbahen me vlerën e kërkuar aktualisht për t'i shlyer ato.

Vlera e realizueshme

Aktivitetet mbahen me vlerën që do të merrej gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit.

Detyrimet mbahen me vlerën që duhet paguar për t'i përbushur ato në rrjedhën normale të biznesit.

Vlera aktuale

Aktivitetet mbahen me vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të parasë që aktivi do të gjenerojë.

Detyrimet mbahen me vlerën aktuale të flukseve dalëse të ardhshme të nevojshme për t'i shlyer ato.

Cështjet aktuale: Materialiteti

Deklarata Praktike e mëposhtme është një dokument ilustrues për P2.

ED 2015/8: Deklarata e Praktikave të SNRF-së - Aplikimi i materialitetit në pasqyrat financiare

Materialiteti si koncept përdoret gjerësisht në raportimin financiar. Qëllimi i kësaj Deklarate Praktike është të ndihmojë drejtimin në zbatimin e konceptit të materialitetit gjatë hartimit të pasqyrave financiare. Përmbajtja kryesore është përmbledhur si më poshtë.

Përcaktimi i materialitetit dhe i përdoruesve

Një element është i rëndësishëm nëse mungesa apo anomalitë e tij do të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve.

Vendimi nëse një zë është material apo jo, përbën gjykim. Për këtë arsye, drejtimi duhet të marrë në konsideratë përdoruesit e pasqyrave financiare.

Përdoruesit kryesorë, sipas Kuadrit, janë investitorë, huadhënës dhe kreditorë të tjerë. Mund të supozohet se përdoruesit kanë njohuri të arsyeshme biznesi. Qëllimi i raportimit financiar është t'u mundësojë këtyre përdoruesve të marrin vendime për sigurimin e burimeve për entitetin raportues.

Nivelet sasiore dhe cilësore

Materialiteti shpesh përcaktohet në mënyrë sasiore (p.sh. si përqindje e aktiveve). Megjithatë, materialiteti duhet gjithashtu të konsiderohet në nivel cilësor. Për shembull, informacionet shpjeguese çorientuese ose të paplota mund të krijojnë mungesa apo anomali të informacionit dhe si pasojë ndikojnë në interpretimin e përdoruesve të pasqyrave financiare.

Disa zëra mund të jenë materiale për arsye të tjera, si:

- Elemente që shkaktojnë mospërputhje me ligjet dhe rregulloret, ose me marrëveshjet e huasë;
- Transaksione që mund të jenë kyçe për operacionet e ardhshme (edhe nëse nuk janë materiale në vitin aktual).

Paraqitja dhe shënimet shpjeguese

Drejtimi duhet të marrë në konsideratë jo vetëm nëse një element është përfshirë në pasqyrat financiare, por gjithashtu se si është paraqitur. Drejtimi duhet të përdorë gjykimin për të përcaktuar nivelin e duhur të grupimit, si dhe nivelin e rëndësisë që ai ka. Si për shembull:

- Vendimi se cilët nënzëra duhet të paraqiten veçmas në pasqyrat financiare;
- Vendimi për nivelin e detajeve që do të përfshihen në shënimet shpjeguese të vitit aktual dhe të vitit të mëparshëm.

Materialiteti dhe praktika

Njësitë ekonomike janë në gjendje të miratojnë disa procedura që pakësojnë kohën dhe koston e hartimit të pasqyrave financiare pa shkaktuar gabime materiale.

Shembuj:

- Kapitalizimi i shpenzimeve kapitale vetëm nëse tejkalon një kufi të caktuar;
- Përzgjedhja e një njësie monetare, të tillë si \$ 1,000, dhe rrumbullakimi në këtë njësi gjatë hartimit të pasqyrave financiare.

Këto zgjedhje duhet të rishikohen rregullisht për tu siguruar që, ato të mos çojnë në një gabim material ose humbje materiale të detajeve.

Gabimet

Është praktikë e mirë për të korrigjuar të gjitha gabimet e identifikuar, materiale ose jo. Megjithatë, korrigjimi i gabimeve jomateriale mund të krijojë shpenzime të panevojshme ose vonesë në publikimin e pasqyrave financiare. Në raste të tilla, drejtimi duhet të marrë parasysh se sa i rëndësishëm është një gabim - p.sh. një gabim në regjistrimin e blerjeve, potencialisht do të ndikonte gjithashtu koston e shitjeve, të detyrimeve dhe inventarit.

Anomalitë materiale të identifikuar para autorizimit të pasqyrave financiare duhet të korrigjohen pavarësisht koston së tyre.

Nëse gabimi material lidhet me një periudhë të mëparshme atëherë ai rregullohet në retrospektive (në përputhje me SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet).

Gabimet e qëllimshme

Ndonjëherë drejtimi mund të zgjedhë të mos veprojë në pajtueshmëri me një kërkesë brenda një Standardi të SNRF-së, sepse ndikimi do të jetë jo-material. Për shembull, drejtimi mund të zgjedhë të mos skontojë një detyrim në vlerën aktuale sepse vlerat e skontuara dhe të paskontura janë shumë të përafërta (nuk ndryshojnë shumë).

Deklarata e Praktikës vëren se kjo ndryshon nga rastet kur drejtimi përdor një normë skontimi të papërshtatshme në mënyrë që të zvogelojë vlerën e detyrimit. Në këtë rast, është e qartë se drejtimi përpiqet të arrijë një paraqitje të veçantë në pasqyrat financiare, prandaj kjo duhet të jetë materiale.

Cështjet aktuale: Kuadri

Drafti i paraqitur më poshtë është një dokument ilustrues për P2.

ED / 2015/3: Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar

Bordi ka identifikuar dobësi në Kuadrin ekzistues:

- Fusha të rëndësishme nuk mbulohen. Për shembull, standardi ekzistues siguron shumë pak udhëzime për paraqitjen dhe dhënien e shënimeve shpjeguese.
- Disa aspekte të Kuadrit ekzistues janë të vjetëruara dhe nuk reflektojnë mendimin aktual të Bordit, siç janë udhëzimet për njohjen e aktiveve dhe detyrimeve.
- Disa udhëzime janë të paqarta, të tilla si mënyra se si trajtohen pasiguritë në matje.

Drafti i paraqitur propozon ndryshime në Kuadër që do të trajtojnë këto dobësi si dhe një numër fushash të tjera.

Objektivat dhe karakteristikat cilësore

Në draftin e paraqitur, Bordi propozon ndryshimin e Kuadrit në mënyrë që:

- Të theksojë rëndësinë e të qenurit i aftë për të vlerësuar administrimin e drejtimit mbi burimet e një entiteti;
- Ri-paraqesë konceptin e kujdesit (ushtrimi i kujdesit gjatë gjykimit) dhe theksimi i rëndësisë së tij në lidhje me paraqitjen besnike të informacionit financiar;
- Të bëjë një deklaratë të qartë se një paraqitje me besueshmëri raporton thelbin ekonomik të një transaksioni dhe jo formën e tij ligjore.

Entiteti raportues

Drafti i paraqitur propozon një përkufizim të entitetit raportues si ai që harton pasqyrat financiare.

Drafti i paraqitur thekson se pasqyrat financiare të konsoliduara janë ato ku kufiri i entitetit raportues bazohet në kontrollin direkt dhe indirekt. Bordi beson se pasqyrat financiare të konsoliduara janë më të dobishme se sa pasqyrat financiare individuale.

Përkufizimet e aktiveve dhe detyrimeve

Drafti i paraqitur propozon përkufizimet e mëposhtme:

- Një aktiv është '**një burim ekonomik aktual i kontrolluar nga entiteti si rezultat i ngjarjeve të kaluara**' (ED / 2015/3, para 4.5)
- Një detyrim është '**një obligim aktual i entitetit për të transferuar një burim ekonomik si rezultat i ngjarjeve të kaluara**' (ED / 2015/3, para 4.24)
- Një 'burim ekonomik' është '**një e drejtë që ka potencialin për të prodhuar përfitime ekonomike**' (ED / 2015/3, para 4.4)

Kjo ndryshon nga përkufizimet aktuale të aktiveve dhe detyrimeve, të cilat deklarojnë se hyrjet ose daljet e përfitimeve ekonomike duhet të jenë të mundshme.

Njohja

Drafti i paraqitur propozon kriteret e njohjes për elementet që përqendrohen në karakteristikat cilësore të informacionit financiar të dobishëm. Propozohet që një element të njihet nëse njohja parashikon:

- Informacion të rendësishëm rreth elementit;
- Një paraqitje me besueshmëri të elementit;
- Përfitimet për përdoruesit e informacionit financiar që tejkalojnë koston e përgatitjes.

Ç'regjistrimi

Kuadri ekzistues nuk trajton ç'regjistrimin.

Drafti i paraqitur e trajton këtë. Ai jep udhëzime për tu siguruar që një njësi ekonomike ofron një paraqitje me besueshmëri të aktiveve dhe detyrimeve të mbajtura pas transaksionit dhe të ndryshimeve në aktivet neto të një entiteti, që rezultojnë nga transaksioni.

Matja

Drafti i paraqitur përshkruan dy metoda të vlerësimit të elementeve:

- Kosto historike
- Vlera aktuale

Drafti i paraqitur propozon udhëzime mbi faktorët që duhen marre në konsideratë gjatë zgjedhjes së një një bazeje vlerësimi.

Paraqitja dhe shënimet shpjeguese

Kuadri ekzistues nuk ofron udhëzime të mjaftueshme për paraqitjen dhe shënimet shpjeguese.

Drafti i paraqitur thekson rëndësinë e komunikimit efektiv. Ai vëren se informacioni financiar duhet të jetë i mirë-strukturuar dhe të mos fshihet nga detaje të panevojshme.

Sa i përket paraqitjes së performancës financiare, drafti i paraqitur thekson se fitimi ose humbja është burimi kryesor i informacionit. Si i tillë, ekziston një supozim i kundërshtueshëm që të ardhurat dhe shpenzimet do të regjistrohen në fitim ose humbje. Drafti i paraqitur propozon që të ardhurat dhe shpenzimet duhet të njihen jashtë fitimit ose humbjes në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse nëse:

- Entiteti mban aktivet ose detyrimet me vlerën aktuale dhe komponentët e ndryshimit të vlerës nuk do të lindin nëse aktivi ose detyrimi është mbajtur me kosto historike; dhe
- Duke përjashtuar elementin nga fitimi ose humbja, rritet rëndësia e informacionit financiar.

Drafti i paraqitur gjithashtu propozon një supozim të kundërshtueshëm që të ardhurat dhe shpenzimet e përfshira në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse do të riciklohen në fitim ose humbje në të ardhmen.

Testoni njohuritë tuaja 1 - Kuadri

Në shtator 2010, Bordi nxori Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar 2010 ('Kuadri'). Megjithatë, propozimet për të rifilluar punën për Kuadrin patën mbështetje shumë shpejt. Kjo çoi në publikimin e një dokumenti diskutimi në vitin 2013 dhe në paraqitjen e një drafti në vitin 2015, që përshkruante ndryshimet e mëtejshme të mundshme në Kuadër. Këto diskutime theksojnë qartë rëndësinë e Kuadrit për përdoruesit dhe hartuesit e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Kërkohe:

Si i përkufizon Kuadri elementët që kanë të bëjnë me pozicionin financiar dhe pse mund të kritikohen këto përkufizime?

2. SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë**Hyrje**

Objektivi i SNRF 13 është të sigurojë një burim të vetëm udhëzimi për matjen e vlerës së drejtë, kur kërkohe nga një standard raportues, në vend që të përhapet në disa standarde të raportimit.

Shumë standarde të kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë që zërat të maten me vlerën e drejtë. Disa shembuj nga studimet tuaja të mëparshme përfshijnë:

- SNK 16 Aktivitet afatgjata materiale, të cilat u mundësojnë njesive ekonomike që të vlerësojnë tokën, ndërtesën, makineritë dhe pajisjet me vlerën e drejtë;
- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit, që kërkon që aktivitet neto të identifikueshme të një filiali të maten me vlerën e drejtë në datën e blerjes.

Objekti

SNRF 13 nuk zbatohet për:

- Transaksionet e pagesave të bazuara në aksione (SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione)
- Qiratë (SNRF 16 Qiratë)

Përkufizimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë përcaktohet si "çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose i paguar për të transferuar një detyrim, në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e vlerësimit" (SNRF 13, paragrafi 9).

Pjesëmarrësit e tregut janë palë të treta të mirinformuara. Kur vlerësojnë një aktiv ose një detyrim, ata duhet të marrin parasysh:

- Gjëndjen
- Vendndodhjen
- Kufizimet në përdorim

Duhet të supozohet se pjesëmarrësit e tregut nuk janë të detyruar të kryejnë transaksione (dmth. Ata nuk vuajnë nga mungesa e rrjedhjes së parasë).

SNRF 13 vëren se ekzistojnë metoda të ndryshme për përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi ose detyrimi:

- Metoda e tregut (vlerësimet e bazuara në çmimet e shitjes së fundit)
- Metoda e kostos (vlerësimet e bazuara në kostot e zëvendësimit)
- Metoda e të ardhurave (vlerësimet bazuar në parashikimet financiare).

Cilado metodë që perdoret, qëllimi është gjithmonë i njëjtë - për të vlerësuar çmimin që do të transferohej në një transaksion me një pjesëmarrës tregu.

Çmimi

Vlera e drejtë është një vlerësim i bazuar në një treg, jo në një entitet specifik. Si e tillë, kur përcaktohet çmimi me të cilin do të shitet një aktiv (ose çmimi i paguar për transferimin e një detyrimi), duhet të përdoren të dhënat e vëzhgueshme nga tregjet aktive aty ku është e mundur.

Një **treg aktiv** është një treg ku transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin shpesh.

SNRF 13 klasifikon inputet në teknikat e vlerësimit në tre nivele.

- Niveli i inputeve 1 është çmimi i kuotuar për aktivet identike në tregjet aktive.
- Niveli i inputeve 2 janë çmime të vëzhgueshme që nuk janë inputet e nivelit 1. Kjo mund të përfshijë:
 - Çmimet e kuotuar për aktive të ngjashme në tregjet aktive;
 - Çmimet e kuotuar për aktive identike në tregjet më pak aktive;
 - Inpute të vëzhgueshme që nuk janë çmime (siç janë normat e interesit).
- Inputet e nivelit 3 janë të pavëzhgueshme. Kjo mund të përfshijë parashikimin e parasë së gatshme ose të fitimit duke përdorur të dhënat e veta të një entiteti.

Një rregullim i rëndësishëm për një input të nivelit 2 do të çonte në kategorizimin e tij si një input i nivelit 3.

Prioritet i jepet inpueteve të nivelit 1. Prioritet më i ulët jepet inpueteve të nivelit 3.

Inputet për të përcaktuar vlerën e drejtë

SNRF 13 jep shembujt e mëposhtëm të inpueteve të përdorura për të përcaktuar vlerën e drejtë:

	Aktivitet	Shembull
Niveli 1	Aksionet e kapitalit në një entiteti të listuar	Çmimet e kuotuar të pakorrigjuara në një treg aktiv.
Niveli 2	Ndërtesa e mbajtur dhe e përdorur	Çmimi për metër katror për ndërtesën nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut, siç janë transaksionet e vëzhguara për objekte të ngjashme në vende të ngjashme.
Niveli 3	Njësia gjeneruese e parasë	Fitimi ose parashikimi i rrjedhës së parasë duke përdorur të dhënat e veta.

Testoni njohuritë tuaja 2 - Baklava

Baklava ka një aktiv afatgjatë material të investuar që matet me vlerën e drejtë. Ky aktiv është dhënë me qira afatshkurtër.

Drejtorët dëshirojnë të vlerësojnë vlerën e drejtë të aktivit duke vlerësuar vlerën aktuale të flukseve monetare neto që do të gjenerojë aktivi për Baklavan.

Ata argumentojnë se kjo pasqyron më së miri mënyrën në të cilën aktivi do të gjenerojë përfitime ekonomike për Baklavan.

Ndërtesa është unike, megjithëse ka pasur shumë shitje të ndërtesave të ngjashme në zonën lokale.

Kërkohet:

Diskutoni nëse teknikat e vlerësimit të sugjeruara nga drejtuesit janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Tregjet

Çmimi i marrë kur një aktiv është shitur (ose paguhet kur një detyrim transferohet) mund të ndryshojë në varësi të tregut specifik ku transaksioni ndodh.

Tregu kryesor

SNRF 13 thotë se vlera e drejtë duhet të matet duke iu referuar tregut kryesor.

Tregu kryesor është tregu me aktivitetin më të madh për aktivin ose detyrimin që matet.

Entiteti duhet të jetë në gjendje të hyjë në tregun kryesor në datën e vlerësimit. Kjo do të thotë që tregu kryesor për të njëjtin aktiv mund të ndryshojë midis entiteteve.

Tregu më i favorshëm

Nëse nuk ka treg kryesor, atëherë vlera e drejtë matet duke iu referuar çmimeve të tregut më të favorshëm.

Tregu më i favorshëm është ai që maksimizon shumën neto të marrë nga shitja e një aktivi (ose minimizon shumën e paguar për transferimin e një detyrimi).

Kostot e transaksionit (siç janë tarifat ligjore dhe të ndërmjetësit) do të luajnë një rol në përcaktimin e tregut më të favorshëm. Megjithatë, vlera e drejtë nuk është e rregulluar për kostot e transaksionit, sepse ato janë një karakteristikë e tregut, më tepër se e aktivit.

Testoni njohuritë tuaja 3 - Tregjet

Një aktiv është shitur në dy tregje të ndryshme aktive me çmime të ndryshme. Një entitet hyn në transaksione në të dy tregjet dhe mund të aksesojë çmimin në ato tregje për aktivin, në datën e matjes si më poshtë:

	Tregu 1	Tregu 2
	\$	\$
Çmimi	26	25
Kostot e transaksionit	(3)	(1)
Kostot e transportit	<u>(2)</u>	<u>(2)</u>
Çmimi neto i marrë	21	22

Cila është vlera e drejtë e aktivit nëse:

(a) Tregu 1 është tregu kryesor i aktiveve?

(b) Nuk mund të përcaktohet tregu kryesor?

Aktivët jofinanciare

Çfarë është një aktiv jofinanciar?

Ndryshimi midis aktiveve financiare dhe jo-financiare trajtohet në detaje në Kapitullin 11. Aktivët financiare përfshijnë:

- Të drejtat kontraktuale për të marrë mjete monetare (siç janë të arkëtueshmet);
- Investimet në aksione të kapitalit.

Aktivët jofinanciare përfshijnë:

- Tokën, ndërtesën, makineritë dhe pajisjet;
- Aktivët jo-materiale.

Vlera e drejtë e një aktivi jofinanciar

SNRF 13 thotë se vlera e drejtë e aktiveve jo-financiare duhet të bazohet në përdorimin **më të lartë dhe më të mirë të saj**.

Përdorimi më i lartë dhe më i mirë i një aktivi është përdorimi që një pjesëmarrës i tregut do të pranonte për të maksimizuar vlerën e tij.

Përdorimi aktual i një aktivi jofinanciar mund të supozohet të jetë përdorimi më i lartë dhe më i mirë, përveç nëse ekzistojnë dëshmi për të kundërtën.

Përdorimi më i lartë dhe më i mirë duhet të marrë parasysh përdorimet që janë:

- Fizikisht të mundshme
- Ligjërisht të lejueshme
- Financiarisht të mundshme.

SNRF 13 thotë se një përdorim mund të lejohet ligjërisht edhe nëse nuk është miratuar ligjërisht.

Testoni njohuritë tuaja 4 – Five Quarters

Five Quarters ka blerë 100% të aksioneve të zakonshme të Three Halves dhe po përpiqen të përcaktojë vlerën e drejtë të aktiveve neto në datën e blerjes.

Three Halves zotëron tokën që aktualisht është zhvilluar për përdorim industrial. Vlera e drejtë e tokës nëse përdoret në një operacion prodhimi është 5 milionë dollarë.

Shumë parcela afër me tokën janë zhvilluar për përdorim rezidencial (si ndërtesa të larta apartamentesh). Toka në pronësi të Three Halves nuk ka leje planifikimi për përdorim rezidencial, edhe pse leje të tilla janë dhënë për parcela të ngjashme toke. Vlera e drejtë e tokës së Three Halves si vend i lirë për zhvillimin rezidencial është 6 milionë dollarë. Megjithatë, shpenzimet e transformimit prej \$ 0.3 milion do të duhet të ndodhin për të sjellë tokën në këtë gjendje.

Kërkohet:

Si duhet të përcaktohet vlera e drejtë e tokës?

Dhënia e shënimeve shpjeguese

Dhënia e shënimeve shpjeguese duhet të ofrojë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë inputet dhe metodat e përdorura për të përcaktuar se si janë arritur matjet me vlerën e drejtë.

Niveli në hierarkinë e vlerësimit me tre nivele duhet të paraqitet, së bashku me detajet mbështetëse të metodave të vlerësimit dhe inputeve të përdorura aty ku është e përshtatshme. Siç pritet, kërkohet informacion më i detajuar kur ka përdorim domethënës të inputeve të nivelit të tretë për të arritur në matjen e vlerës së drejtë, për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë se si janë arritur vlerat e tilla të drejta.

Dhënia e shënimeve shpjeguese duhet gjithashtu të bëhet kur ka një ndryshim të teknikës së vlerësimit për të matur një aktiv ose detyrim. Kjo do të përfshijë çdo ndryshim në nivelin e inputeve të përdorura për të përcaktuar vlerën e drejtë të aktiveve dhe / ose detyrimeve të veçanta.

Përmbledhje e kapitullit**Kuadri Konceptual**

- Përmirësimi i standardeve të kontabilitetit
- Karakteristikat themelore cilësore të informacionit të dobishëm janë:
 - Përkatësia
 - Paraqitja besnike
- Përcakton elementët e pasqyrave financiare

**SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë**

- Siguron një burim të vetëm udhëzimi ku kërkohet matja e vlerës së drejtë
- Hierarkia e vlerës së drejtë - 3 nivele

Testoni njohuritë tuaja - Zgjidhjet

Testoni njohuritë tuaja 1 – Kuadri Konceptual

Kuadri (para 4.4) siguron këto kufizime:

- 'Një aktiv është një burim i kontrolluar nga entiteti, që rrjedh nga ngjarjet e kaluara dhe nga i cili pritet të rrjedhin përfitime ekonomike në të ardhmen.
- Një detyrim është një obligim aktual i entitetit që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, dhe nga i cili pritet të rezultojë në një dalje nga njësia ekonomike të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike.
- Kapitali është interesi i mbetur në aktivet e njësisë ekonomike pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj.'

Kritikat e mëposhtme mund të bëhen për keto përkufizime:

- Përkufizimet zbatohen në mënyrë jokonsistente në të gjithë standardet SNRF dhe SNK;
- Koncepti i "kontrollit" nuk është i përcaktuar qartë dhe mund të jetë i vështirë për t'u zbatuar;
- Ka mungesë të udhëzimeve në lidhje me kuptimin e një 'burimi ekonomik';
- Nocioni i 'pritjes' është i paqartë. A i referohet probabilitetit të fluksit rrjedhjës apo një 'vlere të pritur' matematikore?;
- Përkufizimet nuk ofrojnë udhëzime të mjaftueshme për diferencën midis detyrimeve dhe kapitalit. Udhëzime të mëtejshme këtu do të përfitonin përdoruesit, veçanërisht kur aplikohen këto koncepte për instrumentet financiare.

Testoni njohuritë tuaja 2 - Baklava

Vlerësimi i drejtuesve për flukset monetare neto të ardhshme që ndërtesa do të gjenerojë është një input i nivelit 3. SNRF 13 jep përparësi më të ulët për inputet e nivelit 3. Këto nuk duhet të përdoren nëse ekziston një nivel i nivelit 1 ose niveli 2.

Të dhënat e vëzhgueshme rreth çmimit të fundit të shitjes së pronave të ngjashme janë një input i nivelit 2. Vlera e drejtë e ndërtesës duhet të bazohet në këto çmime, me rregullime të bëra sipas nevojës për të pasqyruar vendndodhjen dhe gjendjen specifike të ndërtesës së Baklavas.

Testoni njohuritë tuaja 3 - Tregjet

(a) Nëse Tregu 1 është tregu kryesor atëherë vlera e drejtë do të matet duke përdorur çmimin që do të merrej në atë treg minus shpenzimet e transportit. Vlera e drejtë do të ishte , \$ 24 (\$ 26 - \$ 2). Kostot e transaksionit injorohen pasi ato nuk janë karakteristike e aktivit.

(b) Nëse asnjëri nga tregjet nuk është treg kryesor për aktivin atëherë vlera e drejtë do të matet në tregun më të favorshëm. Tregu më i favorshëm është tregu që maksimizon shumën neto të marrë nga shitja.

Shuma neto e marrë në Tregun 2 (\$ 22) është më e lartë se shuma neto e marrë në Tregun 1 (\$ 21). Prandaj Tregu 2 është tregu më i favorshëm. Kjo rezulton në një matje me vlerë të drejtë prej \$ 23 (\$ 25 - \$ 2). SNRF 13 specifikon se kostot e transaksioneve luajnë një rol kur përcaktojmë se cili treg është më i favorshëm, por që ato nuk janë faktorë në vetë matjen e vlerës së drejtë.

Testoni njohuritë tuaja 4 – Five Quarters

Toka është një aktiv jofinanciar. SNRF 13 thotë se vlera e drejtë e një aktivi jo-financiar duhet të bazohet në përdorimin e tij më të lartë dhe më të mirë. Ky supozohet të jetë përdorimi i saj aktual, përveç nëse ekziston evidencë për të kundërtën.

Përdorimi aktual i aktivit do të sugjeronte një vlerë të drejtë prej \$ 5 milion.

Megjithatë, ka evidenca se pjesëmarrësit e tregut do të jenë të interesuar në zhvillimin e tokës për përdorim rezidencial.

Përdorimi rezidencial i tokës nuk është ligjërish i ndaluar. Parcelave të ngjashme të tokës u është dhënë leje ndërtimi, prandaj është e mundur që kjo parcelë toke të pajiset me leje ndërtimi.

Nëse përdoret për qëllime banimi, vlera e drejtë e tokës do të ishte \$ 5.7 milion (\$ 6m - \$ 0.3m).

Duket se përdorimi më i lartë dhe më i mirë i tokës është për zhvillim rezidencial. Prandaj, vlera e saj e drejtë është \$ 5.7 milion.